



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



Drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër  
12- Zyrtarisht /2023  
Deçan.30.01.2023

Për: Kryetarin e Komunës së Deçanit  
Z. Bashkim Ramosaj

Përmes: Drejtorit të Drejtorisë Z. Agron Muslijaj

Nga : Shefi i Drejtorisë Z. Hasan Hulaj

Lënda: Plani i Punës për periudhën 04 Janar 2023 – Dhjetor 2023,  
i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Deçanit



Së bashku me këtë shkresë do gjeni edhe Plani i Punës për periudhën 04 Janar 2023 – Dhjetor 2023, i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Deçanit

	REPUBLIKA E KOSOVËS DEÇANI MUNICIPALITY DREJTORIA PËR GJEODEZI DHE KADASTËR OPSTINA DEÇAN
DPJ. KADASTER	3049
02	30.01.23

## PLAN P UNE

### Për periudhën Janar — Dhjetor 2023 i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër ne Deçan

#### 1. Shefi i Shërbimit njëkohësisht edhe zyrtari për RDPP se bashku me referentën e ndryshimeve kadastrale

Meqenëse Drejtoria jone Kryesisht punon ne baze te kërkesave te palëve , nuk kemi mundësi reale qe te caktojmë volumin e punëve për vitin 2023, por ne duke u bazuar ne statistikat qe i mbajnë për çdo vit mendojmë se ne këtë vit do te ketë trend te rritjes se volumit te punëve krahasuar me vitet paraprake.

Ne vazhdim ne baze te punëve te kryera ne vitet e kaluar dhe bazuar ne trendin e rritjes se kërkesave te palëve po japin një pasqyre e cila do na shërbeje si orientim i synimeve te kryerjes se punëve brenda vitit raportues dhe atë për secilin vend pune.

Zyrtari për RDPP — njëkohësisht Shefi i Drejtorisë për Kadastër dhe Zyrtarja e Ndërrimeve kadastrale planifikojnë qe ne këtë vit te shqyrtoi përafërsisht 800-900 kërkesa te palëve te cilat kane te bëjnë me ndërrimin e pronareve dhe futjen e te dhënave te reja ne sistemin e SIKTK- es.

Krahas këtyre punëve Zyrtari për RDPP i cili i kryen edhe detyrat e shefit te shërbimit i dhe se bashku me Referentin për ndryshime kadastrale kryejnë edhe pune tjera me urdhër te drejtorit dhe sipas nevojës .

## **2. Zyrtarët e mirëmbajtjes se Kadastrit**

Ne këtë sektor punojnë tre zyrtar për mirëmbajtjen e Kadastrit

Këta zyrtar gjate periudhës 01.01.2023 deri 31.12.2023, mendojmë se do kryejnë afro 350 raste tereni sipas kërkesës se palëve për te cilat do bëjnë azhurnimin adekuat neper librat kadastral dhe me pas për këto lëndë nxjerrin vendime adekuate .

Punët ne teren do i kryejnë Kompanitë dhe Gjeodetët e Licencuar për shkak se me ligje kjo pune iu është lënë vetëm Gjeodetëve dhe Kompanive Gjeodete te Licencuara.

Gjithashtu. Këta zyrtar mendojmë se do kryejnë me tepër se 50 raste te lëshuarjes se Historiateve si dhe do dalin ne teren sipas nevojave dhe kërkesave zyrtare te Komunës.

Te njëjtit do kryej edhe detyra tjera sipas nevojave te cilat paraqiten ne këtë shërbim siç janë konsultat me pale dhe pune tjera ne zyre.

## **3. Referenti për pranimin e palëve**

Gjate kësaj periudhe , referenti për pranimin e palëve mendojmë se do pranoje përafërsisht 4500 kërkesa te cilat kryesisht kane te bëjnë me dhënien e certifikatave te pronës se paluajtshme, kopjeve te planit dhe vërtetimeve me te cilat vërtetohet se a ka apo nuk ka pala pasuri te paluajtshme, ne territorin e Komunës etj..


I njëjti zyrtar i procedon te gjitha këto kërkesa dhe për secilën kërkesë palët pajisen me dokumente përkatëse ne afatin brenda ditës se paraqitjes se kërkesës.

Ky plan i punës nuk parasheh 100% punët qe do kryhen gjate vitit 2023 por siç u tha edhe me lartë është plan orientues i cili është përpiluar duke u bazuar ne statistikat e punëve te kryera nga vitet paraprake i qe shihet se për secilin vit ka tendenca te rritjes volumit te punës.

**Raportin e hartoi :**

**Shefi i kësaj Drejtorie**

**Hasan Hulaj**



**Planin e Aprovoi :**

**Drejtori**

**Agron Muslijaj**

